



Vjenë, shtator 2021

Shumë të nderuar persona me të drejtë kujdestarie, të dashur prindër

para së gjithash, do të donim t'ju falënderonim që e përballuat me sukses këtë periudhë të vështirë prej një viti e gjysmë, së bashku me fëmijët tuaj dhe pedagogët e pedagoget në shkollën e fëmijës suaj!

Objektivi ynë i përbashkët dhe i rëndësishëm në vitin e ardhshëm shkollor është që të gjithë fëmijët, megjithë pandeminë më të madhe të shekullit, ta ndjekin shkollën e “tyre” pa ndërprerje. Për ta arritur këtë objektivi, do të vendosim përsëri, sidomos në tre javët e para pas fillimit të shkollës, një rrjet sigurie me anë të testeve të rregullta nëpër të gjitha shkollat.

Mbrojtjen më të rëndësishme nga korona e në këtë mënyrë edhe për shoqërinë tonë, si dhe për funksionimin e sigurt të shkollës, e përfaqëson vaksina. Sa më shumë njerëz të vaksinohen, aq më e mirë është mbrojtja dhe aq më e madhe edhe “liria” jonë sociale.

Pas kësaj kohe të mundimshme gjatë vitit të fundit shkollor, sidomos fëmijët kanë nevojë pikërisht për këtë liri, si dhe për mësimin e përbashkët, që iu ofron atyre shkolla.

Ne mund t'i mbështesim fëmijët tanë në fazën aktuale të pandemisë - veçanërisht ata nën moshën 12 vjeç - duke e pranuar vetë ne të rriturit mundësinë e një vaksinimi mbrojtës nga korona.

Për fëmijët mbi moshën 12 vjeç janë lejuar tashmë disa vaksina (Spikevax nga Moderna dhe Comirnaty nga BioNTech/Pfizer). Ato janë kontrolluar rreptësisht nga Agjensia Evropiane e Barnave (EMA) dhe konsiderohen si të sigurta dhe të efektshme. Fëmijët dhe të rinjtë rrallë sëmuren rëndë me COVID-19 në krahasim me të rriturit, megjithatë ata janë po ashtu ngjites si këta.

Në të gjitha landet e Federatës ka oferta vaksinimi në dispozicion që nuk kërkojnë shumë mundim, bile edhe pa regjistrim. Ju lutemi informohuni direkt në landin tuaj ose te www.oesterreich-impft.at për mundësitë e vaksinimit për ju dhe ndoshta edhe për fëmijën apo fëmijët tuaj. Për shembull te www.sichereschule.at mund të kërkonte edhe stacionin më të afërt të vaksinimit për fëmijë dhe të rinj.

Gemeinsamer Brief zum Schulstart des Herrn Bundesministers mit Vertretern des Elternbeirates -
Albanisch

Fëmijët dhe të rriturit, të cilët nuk e kanë mbushur ende moshën 14 vjeç, duhet të shoqërohen gjatë vaksinimit nga njëri prej prindërve dhe kanë nevojë për miratimin e tyre që të vaksinohen. Pas moshë 14 vjeç, ata mund të vendosin vetë.

Ne të gjithë, të cilët duam të ndihmojmë për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rinjve tanë, duhet ta bëjmë këtë brenda mundësive tona. Dhe për shumicën prej nesh vaksinimi është një mundësi.

Ne gëzohemi së bashku me ju për fillimin e shkollës dhe ju urojmë juve dhe fëmijës apo fëmijëve tuaj një vit shkollor të mbarë dhe plot gëzim 2021/22!

Univ-Prof. Dr. Heinz Faßmann
Ministër Federal për Arsimin, Shkencën dhe
Kërkimin shkencor

Mag. Bernhard Baier
President i Ligës së Famijeve Austriake
(Österreichischer Familienbund)

Thomas Maximiuk
President i Lidhjes Kryesore të Shoqatave Katolike
të Prindërve (Hauptverband katholischer
Elternvereine)

Christian Oxonitsch
Kryetar i Organizatës „Österreichische
Kinderfreunde“

Alfred Trendl
President i Lidhjes Katolike të Familjeve
(Katholischer Familienverband Österreich)